



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 28 (827726)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 9 Korrik 2021

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Francën



Anija franceze Pluton (M662)-vizitë portuale në Portin Detar Vlorë

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Francën, nga data 1-4 korrik 2021 anija franceze Pluton (M662)-Bâtiment-Base de Plongeurs Démineurs (BBPD) zhvilloi vizitë portuale në Portin Detar Vlorë. Qëllimi i kësaj vizite ishte stërvitja dhe shkëmbimi i eksperiencës ndërmjet efektivave të anijeve, efektivave

zhytës të Qendrës së Zhytjes dhe pastrimi i municioneve nënujore në gjirin e Vlorës. Anija franceze BBPD Pluton u prit në hyrje të ujërave territoriale shqiptare nga anija Oriku, P-132. Gjatë lundrimit për në portin e Vlorës, të dyja anijet zhvilluan stërvitjen e përbashkët PASSEX, ku u përpunuan...

» faqe 2

Në bazën Hohenfels-Gjermani

Përfundon stërvitja "KFOR - 29"



» faqe 4

Nën drejtimin e Komandës të Grup Batalionit Kanadez Niset drejt Letonisë Kontingjenti i 10-të EOD i Batalionit të Xhenios

EOD është një strukturë e besueshme, profesionale sipas standardeve të NATO-s, e aftë të kryejë detyra shumë të vështira

» faqe 3



EOD pastron 200 municione në gjirin e Vlorës

Në bashkëpunim me marinën franceze Pluton (M662)

Efektivët EOD të Komandës Mbështetëse në bashkëpunim me zhytësit e Forcës Detare dhe anijes së marinës kombëtare franceze, Pluton (M662) (Bâtiment-Base de Plongeurs Démineurs-BBPD), kanë punuar së bashku për zhvillimin e operacionit për kërkimin, gjetjen dhe nxjerrjen nga uji të municioneve në gjirin e Vlorës. Gjatë kontrollit të ushtruar në total...



» faqe 2

Bashkëpunimi

Forcat Speciale marrin pjesë në stërvitjen "Anadoly-21"

Stërvitja e Forcave të Bashkuara Speciale "Anadoly-21" u zhvillua nën organizimin e Komandës së Forcave Speciale të Turqisë, me pjesëmarrjen e "Forcave Speciale" nga 7 vende. Në një deklaratë të Ministrisë turke të Mbrojtjes thuhet se Stërvitja e Forcave të Bashkuara Speciale "Anadoly-21", e cila filloi më 28 qershor ishte me pjesëmarrjen "de facto" të elementëve...

» faqe 3



JENS STOLTENBERG VIZITË NË KOSOVË

Riafirmohet angazhimi i NATO-s për misionin e KFOR-it

MSC. MIMOZA GOLIKJA

» faqe 8

26 ORË FLUTURIMI MBI TOMOR

Helikopteri "Cougar" në shuarjen e zjarreve në malin e Tomorit

» faqe 5

NË KUADËR TË 78-VJETORIT TË KRIJIMIT

Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së dhe roli i tij në luftën e II Botërore

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

» faqe 6

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Francën

Anija franceze Pluton (M662)-vizitë portuale në Portin Detar Vlorë

Anija franceze Pluton (M662) ka zhvilluar me anijen Oriku P-132 stërvitjen e përbashkët “PASSE” në përputhje me manualët e NATO-s

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Francën, nga data 1-4 korrik 2021 anija franceze Pluton (M662)-Bâtiment-Base de Plongeurs Démineurs (BBPD) zhvilloi vizitë portuale në Portin Detar Vlorë. Qëllimi i kësaj vizite ishte stërvitja dhe shkëmbimi i eksperiencës ndërmjet efektivave të anijeve, efektivave zhytës të Qendrës së Zhytjes dhe pastrimi i municioneve nën ujë në gjirin e Vlorës.

Anija franceze BBPD Pluton u prit në hyrje të ujërave territoriale shqiptare nga anija Oriku, P-132. Gjatë lundrimit për në portin e Vlorës, të dyja anijet zhvilluan stërvitjen e përbashkët PASSEX, ku u përpunuan elementë të manovrimit taktik dhe furnizimit në det në përputhje me manualët e NATO. Anija franceze u prit në port nga komandanti i Flotiljes Detare kapiten i rangut II Sabri Gjinollari, zëvendësambasadorja franceze Claire Nantier, zëvendësatasheu ushtarak francez, major Yann Maillard si edhe personel nga i Flotiljes Detare.

Pas bregëzimit të anijes komandanti i anijes kapiten i rangut III Barazer De Lannurien ftoi në bordin e anijes komandantin e Flotiljes Detare, kapiten i rangut II Sabri Gjinollari. Komandanti i Flotiljes Detare i uroi komandantit të anijes BBPD Pluton mirëseardhjen në vendin tonë. Gjithashtu kapiten i rangut II Gjinollari uroi një stërvitje sa më të frytshme dhe qëndrim të këndshëm në Vlorë.

Komandanti i anijes BBPD Pluton nga ana e tij falënderoi komandantin e Flotiljes Detare për pritjen dhe e njohu atë me misionin dhe detyrat që kryen anija BBPD Pluton. Gjithashtu gjatë kësaj kohe u mbajt edhe një takim ndërmjet zhytësve francezë dhe palombarëve shqiptar të Qendrës së Zhytjes, për planifikimin e zhvillimit të operacionit për heqjen e municioneve në zonën e Kalasë, Gjiri i Vlorës. Ky operacion u zhvillua gjatë gjithë kohës së qëndrimit të anijes franceze dhe në operacion u angazhuan palombarët e të dy palëve, 2 gomonet e anijes BBPD Pluton, anija Shkumbini, P-03, gomonia e anijes Oriku, P-132 si dhe gomonia e Qendës së Zhytjes.

Komandanti i anijes franceze gjatë qëndrimit në Vlorë zhvilloi një vizitë korteze në Bashkinë e Vlorës, ku u pritën nga nënkryetari Aulona Veizi. Zonja Veizi e njohu komandantin e anijes franceze me qytetin dhe potencialin turistik të tij.

Pas vizitës në Bashkinë e Vlorës, komandanti i anijes BBPD Pluton zhvilloi një vizitë në Bazën Detare të Pashalimanit, ku u pritën nga komandanti i Flotiljes Detare kapiten i rangut II Sabri Gjinollari dhe oficerë të shtabit. të cilët i njohën miqtë me strukturën, misionin, zhvillimin dhe modernizimin e deritanishëm të Forcës Detare në përgjithësi dhe Flotiljes Detare në veçanti. Në datën 4 korrik 2021 anija franceze BBPD Pluton u largua nga ujërat territoriale shqiptare e shoqëruar nga anija e Flotiljes Detare.



EOD PASTRON 200 MUNICIONE NË GJIRIN E VLORËS

Në bashkëpunim me marinën franceze Pluton (M662)

Efektivët EOD të Komandës Mbështetëse në bashkëpunim me zhytësit e Forcës Detare dhe anijes së marinës kombëtare franceze, Pluton (M662) (Bâtiment-Base de Plongeurs Démineurs-BBPD), kanë punuar së bashku për zhvillimin e operacionit për kërkimin, gjetjen dhe nxjerrjen nga uji të municioneve në gjirin e Vlorës. Gjatë kontrollit të ushtruar në total janë zbuluar dhe nxjerrë rreth 220 municione të kalibrave të ndryshëm.

Ekipi EOD pasi mori në dorëzim municionet e gjetura, bëri transportimin e tyre në drejtim të vendit të grumbullimit të tyre, në bazën detare të Pashalimanit. Ekipi EOD ka bërë transportimin e sigurt të tyre në drejtim të depos së municioneve të Batalionit të Xhenios ku do të administrohen deri në asgjësimin përfundimtar.



Operacioni për pastrimin e municioneve nga Gjiri i Vlorës, ku mori pjesë edhe anija e marinës kombëtare franceze, Pluton (M662) është përshën-

detur edhe nga Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi. “Gjiri i Vlorës është tashmë më i pastër dhe më i sigurt. Zhytësit shqiptarë dhe francezë nxorën nga fundi

i detit rreth 220 municione të kalibrave të ndryshëm, të cilat iu dorëzuan për asgjësim xhenierëve tanë”, shkruan ministri Peleshi në facebook.

Nën drejtimin e Komandës të Grup Batalionit Kanadez

Niset drejt Letonisë Kontingjenti i 10-të EOD i Batalionit të Xhenios

EOD është një strukturë e besueshme, profesionale sipas standardeve të NATO-s, e aftë të kryejë detyra shumë të vështira

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë më 1 korrik 2021, në ceremoninë e përcjeljes së Kontingjentit të 10-të EOD të Batalionit të Xhenios, në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni, nën drejtimin e Komandës së Grup Batalionit Kanadez, i cili përkon edhe me 53-vjetorin e krijimit të armës së xhenios.

Në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni, SHSHPFA, gjeneralmajor Begaj pasi falënderoi të pranishmit theksoi se profesionalizmi i treguar, trajnimet me aleatët dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë strukturën EOD një strukturë të besueshme, profesionale dhe specialitet “niche”, siç e quan NATO, për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë, e aftë të kryejë detyra shumë të vështira.

“Si unë edhe ministri i Mbrojtjes ndihemi krenarë me ju, kur dëgjojmë vlerësimet pozitive nga homologët tanë gjatë takimeve të nivelit të lartë në NATO. E njëjta gjë u përcoll edhe nga autoritetet letoneze gjatë vizitës së ministrit të Mbrojtjes në Letoni në fillim të muajt qershor. Unë kam besim që edhe personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës që i është ngarkuar dhe do të mbajë lart dhe me krenari flamurin kombëtar në Letoni.” - u shpreh ndër të tjerë gjeneralmajor Begaj. Më tej gjatë fjalës së tij, SHSHPFA u ndal dhe në rëndësinë që ka jo vetëm prezenca e kontingjentit, por edhe promovimi i paqes, duke dhënë një mesazh të qartë ndaj kundërshtarëve të NATO-s, për gatishmërinë e Shqipërisë për përmbushjen e Nenit 5 të NATO-s. “Imazhi juaj, realizimi i detyrave që nga ato rutinë dhe operacionale kërkojnë një vëmendje të shtuar, gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm.” Gjeneralmajor Begaj gjithashtu adresoi një falënderim të veçantë për të gjithë burrat dhe gratë që kanë shërbyer në këto njësi dhe shprehu respekt pafund për ata heronj që kanë rënë në krye të detyrës për të na bërë ne më të sigurt. Duke përfunduar, shefi



i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj i siguroi ata dhe familjarët e tyre se do të kenë në çdo çast mbështetjen dhe përkujdesjen e Shtabit të Përgjithshëm të

FA-së, por edhe të tijen personalisht, për të arritur rezultatet më të mira në përmbushjen e misionit të tyre dhe u uroi suksese dhe kthim shëndosh e mirë në atdhe.



Nën Komandën e Forcave Speciale të Turqisë

Forcat Speciale marrin pjesë në stërvitjen “Anadoly-21”

Stërvitja e Forcave të Bashkuara Speciale “Anadoly-21” u zhvillua nën organizimin e Komandës së Forcave Speciale të Turqisë, me pjesëmarrjen e “Forcave Speciale” nga 7 vende. Në një deklaratë të Ministrisë turke të Mbrojtjes thuhet se Stërvitja e Forcave të Bashkuara Speciale “Anadoly-21”, e cila filloi më 28 qershor ishte me pjesëmarrjen “de facto” të elementëve të forcave speciale të Turqisë, Shqipërisë, Azerbajxhanit, Katarit, Kazakistanit, Pakistanit dhe Uzbekistanit, dhe me pjesëmarrjen si vëzhgues të Kosovës dhe Mongolisë.

Stërvitja u zhvillua nën organizimin e Komandës së Forcave Speciale të Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, në Ankara me qëllimin për të zhvilluar miqësinë, bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet elementëve të Forcave Speciale, për të ndarë informacionin dhe përvojën reciproke si dhe zhvillimin e aftësisë për të kryer operacione së bashku.



NË GARNIZONIN E FLOTILJES DETARE, PASHALIMAN



Zhvillohen stërvitjet “Adriatiku 21” dhe “Juba 21”

Nga data 27 qershor deri më 2 korrik, Batalioni II i Këmbësorisë në Rreth-Greth, si dhe Batalioni Komando në garnizonin e Flotiljes Detare, Pashaliman, kanë zhvilluar stërvitjet fushore-ujore “Adriatiku 21” dhe “Juba 21” në zbatim të matricës së stërvitjeve të Forcës Tokësore.

Qëllimi i kësaj stërvitje ishte rritja e kushteve fizike të personelit, përvetësimi i teknikave të notimit, i teknikave për kalimin e pengesave ujore, si dhe aftësimi i përdorimit të mjeteve lundruese me dhe pa motor në interes të përballimit të emergjencave civile. Të dy batalionet treguan edhe njëherë se përkushtimi, përgatitja e lartë fizike dhe puna në grup janë ato që i bëjnë këto stërvitje më të lehta për t’u përballuar.

Në bazën Hohenfels-Gjermani

Përfundon stërvitja “KFOR - 29”

Në këtë stërvitje morën pjesë gjashtë shtete: Shqipëria, SHBA, Kosova, Moldavia, Maqedonia e Veriut dhe Italia.

Nga data 5 deri më 30 qershor, në bazën e trajnimeve ndërkombëtare Hohenfels, Gjermani, u zhvillua stërvitja “KFOR-29”. Vendi ynë në këtë stërvitje u përfaqësua nga efektivët e Kompanisë I të Batalionit I të Këmbësorisë (b1k). Në këtë stërvitje morën pjesë gjashtë shtete: Shqipëria, SHBA, Kosova, Moldavia, Maqedonia e Veriut dhe Italia.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte bashkëpunimi në zona operacionale gjithëpërfshirëse midis shteteve në kuadër të Operacioneve të Mbështetjes së Paqes.

“KFOR-29” bazohet në mjedisin e operacioneve aktuale dhe është i dizajnuar për të përgatitur njësitë për Operacione në Mbështetje të Paqes si dhe në mbështetje të autoriteteve civile. Kjo stërvitje synon rritjen e ndërveprimit të trupave gjatë stërvitjes për Operacionet e Mbështetjes së Paqes dhe praktikimin e procedurave standarde të drejtimit të trupave.

Temat kryesore që u zhvilluan duke respektuar të gjitha masat protokollare për mbrojtjen nga virusi COVID-19 ishin: patrullë e kufirit, patrullë me mjete, pikë-vrojtimi dhe kontroll turme. “KFOR-29” rriti më tepër aftësitë individuale ndërvepruese të ushtarakëve shqiptarë në mjediset multinacionale duke rritur njëkohësisht edhe aftësitë profesionale të personelit drejtues oficer dhe nënoficer.



NË GARNIZONIN RINAS

90-Vjetori i Krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore

Në Garnizonin Rinas u zhvillua më 1 korrik 2021, ceremonia me rastin e 90-Vjetorit të Krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore. Në aktivitet ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, ish-komandanti i Mbrojtjes Kundërajrore, gjeneral brigade në rezervë Ylli Dimraj, veteranë të kësaj arme në vite si dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore.

Në fjalën e hapjes, kolonel Ylli Pulaj pasi i uroi mirëseardhjen të ftuarve përshkroi rrugëtimin e Armës Kundërajrore në vite duke evidentuar edhe disa momente të rëndësishme historike.

Në vijim, kolonel Pulaj shprehu mirënjohjen për familjarët e dëshmorëve të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore të rënë në krye të detyrës duke i përkujtuar ata me respekt e nderim. Kolonel Pulaj theksoi gjithashtu, kontributin e veçantë të Mbrojtjes Kundërajrore gjatë luftës në Kosovë, duke realizuar vrojtimin e pandërprerë të hapësirës ajrore dhe krijimin e lehtësirave për realizimin e op-



eracioneve ajrore të NATO-s në Kosovë.

Në përfundim të fjalës së tij, zëvendëskomandanti, kolonel Ylli Pulaj përmendi kontributin aktual të Forcës Ajrore me personel në strukturat ajrore operacionale dhe taktike të NATO-s, si dhe projektet për asetet moderne të vëzhgimit ajror dhe kompletimit me elementë

të mbrojtjes ajrore të bazuara në tokë, në vitet në vazhdim.

Në emër të shoqatës së Mbrojtjes Kundërajrore përshëndeti gjeneral brigade ® Ylli Dimraj. Në fund të ceremonisë, u shpërndanë medaljet e karrierës për personelin e Forcës Ajrore sipas ligjit.

Batalioni i Xhenios i Komandës Mbështetëse

Ndërtohet ura “bailey” në fshatin Voskop për 15 mijë banorë

Prej disa ditësh specialistët e kompanisë së urave të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse kanë vijuar punimet për ndërtimin e urës “bailey” në Njësinë Administrative Voskop të Bashkisë Korçë, të cilat kanë përfunduar sot me montimin e urës bailey me gjatësi 24m, seksion 1/2 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton. Ndërtimi i kësaj ure është i një rëndësie të veçantë nga pikëpamja sociale dhe ekonomike në shërbim të një komuniteti prej rreth 15.000 banorësh.

Kjo urë lidh 4 fshatra: Voskop, Polen, Ravonik, Turan gjithashtu bën të mundur lidhjen e 4 shkollave 9-vjeçare si dhe 5 qendrave shëndetësore, duke iu mundësuar lehtësi në lëvizje këtij komuniteti. Për ndërtimin e kësaj ure janë angazhuar, 9 specialistë të Togës së Urave si dhe 2 mjete. Punimet vijuan me intensitet të lartë, duke bërë të mundur realizimin në një kohë tepër të shkurtër të kësaj ure kaq të rëndësishme për banorët e zonës.



Forcat Tokësore në operacion për shuarjen e zjarreve

Që prej datës 1 korrik, Batalioni i Tretë i Këmbëtorisë i Forcës Tokësore (b3k) i është përgjigjur menjëherë situatës së krijuar nga zjarret në malin e Tomorit. Prej 5 ditësh Forcat e Armatosura luftuan me flakët që kishin përfshirë malin e Tomorit. Veç ndihmës nga ajri me helikopter, u angazhuan në terren edhe efektivet e b3k. Terreni i vështirë dhe temperaturat e larta e bënë akoma më komplekse këtë ndërhyrje.

Me marrjen e sinjalit të emergjencës pas rënies së zjarreve nga Qendra e Bashkuar Operacionale, Reparti Nr. 1030 i

Poshnjes ka dërguar trupat e gatshme në malin e Tomorit. Në këtë operacion u përfshinë mjete dhe trupa të pajisura me bazë materiale të dedikuara për shuarjen e zjarreve. Ky operacion vazhdoi pa ndërprerje ditën dhe natën, duke freskuar trupat e angazhuara në operacion.

Në gatishmëri për shkak të kësaj situatë ishin të gjitha repartet e Forcës Tokësore me qëllim përballimin e çdo situatë të krijuar nga rënia e zjarreve. Angazhimi i reparteve të Forcës Tokësore ka vazhduar deri në përmirësimin e situatës së krijuar nga zjarret në Shqipëri.



26 orë fluturimi mbi Tomor

Helikopteri "Cougar" në shuarjen e zjarreve në malin e Tomorit

Forca Ajrore me strukturat e saj kryesisht Baza Ajrore Farkë do vijojnë të jenë në gatishmëri për t'iu përgjigjur emergjencave në të gjitha rastet kur do kërkohet ndërhyrja e tyre

Në këto ditë të nxehta të motit, helikopteri Cougar dhe ekuipazhi i tij me pilotë e teknikë në bord, prej pesë ditësh nga java që kaloi kanë kryer operacione për shuarjen e zjarreve në malin e Tomorit.

Ndërhyrja nga ajri e helikopterit Cougar, i pajisur me kovën e posaçme "Bambi Bucket" për shuarjen e zjarrit, ka bërë të mundur mbajtjen nën kontroll, neutralizimin e shuarjen e disa vatrave të zjarrit në këtë zonë, duke realizuar kështu rreth 26 orë fluturimi dhe në kushtet shpesh herë të pamjes së kufizuar për shkak të terrenit të mbuluar nga tymi dhe flakët.

Gjatë këtyre ditëve, pilotët dhe teknikët e helikopterit Cougar kanë punuar ditën e natën me përkushtim për kryerjen me sukses të këtij operacioni. Forca Ajrore me strukturat e saj kryesisht Baza Ajrore Farkë do vijojnë të jenë në gatishmëri për t'iu përgjigjur emergjencave në të gjitha rastet kur do kërkohet ndërhyrja e tyre.



Forcat ushtarake vënë në kontroll zjarrin në pishat e Vithkuqit

Ditën e martë, më 6 korrik, që në orët e para të mëngjesit, forcat ushtarake, pjesë e Detashmentit të Mbrojtjes Civile u angazhuan në mbështetje të Bashkisë Korçë dhe Njësisë Administrative Vithkuq, për vënien në kontroll të zjarrit në pyllin e pishave në Vithkuq. Në bashkëpunim me PMNZSH e bashkisë Korçë dhe punonjësit e njësisë administrative Vithkuq u bënë mundur shuarja e zjarrit. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Forcat e Armatosura do të jenë përkrah autoriteteve lokale e rajonale përgjatë gjithë sezonit të verës për të minimizuar dëmet mjedisore nga zjarret.



Sipas urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes

Përbërja e komisioneve të karrierës dhe afatet

Përbërja e komisioneve sipas përcaktimeve të nenit 22, pika 3, të ligjit nr.59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Kur shqyrtohen oficeret dhe nenoficeret e Agjensisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe nenoficeret e FA, pas marrjes së grades kryekapiter, përberja e komisionit ndryshon sipas nenit 22, pika 3, germa "b", "c", "c", të ligjit nr.59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në këtë rast numri i antarëve të komisionit të karrierës nuk ndryshon (mbetet shtatë), por dy antarët e tjere, të cilët i bashkohen komisionit (oficeret dhe nenoficeret) zëvendësojnë perkohësisht dy antarë të komisionit. Futja e dy antarëve të perkohshëm dhe largimi i dy antarëve të përhershëm përcaktohet me urdhërin e ministrit "Për krijimin e komisioneve të karrierës". Komisioni mbledhet sipas urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes. Komisioni i karrierës, në bazë të nenit 22, pika 5, të ligjit nr.59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i perfundojnë procedurat e punës brenda muajit korrik të çdo viti.



Në ndihmë të komisionit caktohet një sekretar dhe përgjegjësitë e tij përcaktohen në këtë rregullore.

Kurse llogaritja e pikëve administrative mbështetet në kursin institucional, arsimin e lartë, gjuhën angleze, gjuhë të tjera të huaja, rezultatet e testit fizik, medaljet dhe dekoratat. Kurse sasia e pikëve administrative është e ndryshme për kategori të ndryshme ushtarakësh. Këto janë pjesë e urdhërit Nr.886, datë 28.6.2021 "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës", i cili ka hyrë në fuqi në datën e lëshimit të tij.



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

**Qendër organizative, politike
e operative e të gjithë fuqive
të armatosura antifashiste**

Rritja e forcës luftarake e formacioneve ushtarake vullnetare partizane, synimi për të shndërruar LANÇSH në një kryengritje të armatosur, si dhe objektivat për të kaluar në veprime operative-strategjike, në korrik 1943 bënin të domosdoshme krijimin e një organi të specializuar për drejtim ushtarak. Për këtë qëllim Këshilli i Përgjithshëm Antifashist NÇ (KANÇSH) më 10 korrik 1943 në Labinot të Elbasanit formoi Shtabin e Përgjithshëm të UNÇSH-së, që përbën një nga ngjarjet më të madha në Luftën Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Ky shtab nuk kishte formë dhe përmasa klasike të shtabit të një ushtrie moderne, por kishte origjinalitetin dhe veçoritë e veta organizative. Në vendimin për krijimin e tij, KANÇSH e përcaktonte Shtabin e Përgjithshëm "... si një qendër organizative, politike e operative e të gjithë fuqive të armatosura antifashiste". Për qëndresën e armatosur popullore kundër pushtuesit, gati çdo gjë, veç vullnetit të pashtershëm e të pa epur të popullit për liri e përparim, filloi gati nga embrionet. Kjo më e dukshme ishte në pamjen ushtarake.

Në rrethana të tilla, djem dhe vajza të popullit me veprimeve konkrete, u futën në radhët e shtresave të ndryshme të popullsisë për ta bindur, bashkuar e organizuar për luftë të armatosur për çlirimin e vendit nga pushtuesi. Përfaqësues të rrymave të ndryshme nacionaliste dhe të Partisë Komuniste të Shqipërisë (përkatesisht 12 e 6 veta), u mbledhën më 16 shtator 1942 në Pezë, duke krijuar Frontin Nacionalçlirimtar. Ky i fundit, si organ më të lartë politiko-ushtarak në shkallë vendi, krijoi Këshillin e Përgjithshëm NÇ. Fryma e detyrat që shtrioi Konferenca e Pezës dhe shtrirja e tyre në masat e gjëra popullore, bënë që deri nga mesi i vitit 1943, qëndresa e armatosur popullore të merrte shtrirje të gjerë. Në radhët e formacioneve partizane kishte rreth 10.000 partizanë të përfshirë në 20 batalione e mbi 30 çeta partizane, krahas rreth 20.000 të tjerëve në radhët e forcave vullnetare e territoriale. Ky zhvillim i organizimit ushtarak dhe i veprimeve luftarake kishte bërë që anë e kënd Shqipërisë të krijoheshin "Zona të Lira" si në Pezë, Kurvelesh, Mesaplik, Skrapar, Gorë-Opar, Çermenikë, Martanesh, Dibër, Tropojë, Mbishkodër etj., duke mbuluar gati 50% të territorit të vendit. Në këtë mënyrë ishin krijuar kushtet optimale të domosdoshme për të kaluar në një shkallë më të lartë të organizimit ushtarak por edhe të objektivave të luftës çlirimtare. Por, jo vetëm zhvillimet e brendshme por edhe ato të jashtme, në kuadrin e Koalicionit të Madh Antifashist, kishin shënuar kthesën e madhe në fatet e Luftës së Dytë Botërore. Kishin përfunduar me asgjësimin e grupimit gjerman betejat e El Alaimanit dhe të Stalingradit, si betejat fillestare të kthesës së madhe, kishte filluar operacioni desant detar në Sicili dhe në Frontin e Lindjes përgatitje beteja e Kurskut që do të shënonte kthesën përfundimtare në fatet e gjithë luftës. Tashmë vështrimi i aleatëve të mëdhenj po drejtohej më pranë Ballkanit dhe Europës Qendrore.

Organ i specializuar ushtarak

Në këto rrethana, në kuadrin e brendshëm, krejt natyreshëm dilte nevoja e krijimit të një organi të specializuar ushtarak për drejtimin operativo-strategjik të luftës

Në kuadër të 78-vjetorit të krijimit

Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së dhe roli i tij në luftën e II Botërore



brenda vendit, por edhe për koordinimin e veprimeve me forcat aleate. Ky organ ishte Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së. Ai u krijua me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Si vetë Këshilli që kishte karakter pluralist, edhe Shtabi i Përgjithshëm, për nga përbërja, kishte po karakter të tillë. Krahas përfaqësuesve të PKS-së, si formacioni kryesor politik i luftës (Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Ramadan Çitaku, Mustafa Gjinishi, Nako Spiru, Dali Ndreu, Bedri Spahiu) në përbërje të tij u futën edhe nacionalistë që pranonin platformën e Frontit NÇ për luftën (Myslim Peza, Abaz Kupi, Haxhi Lleshi, Baba Faja, Spiro Moisiu). Shtabi i Përgjithshëm, në mbledhjen e tij të parë, sikurse shprehet në procesverbalin përkates, "... zgjodhi unanimisht si komandant të shtabit z. Spiro Moisiu..., dhe si komisar z. Enver Hoxha". Ai përcaktoi edhe strukturën

pranë komandave vartëse etj., përcaktoi kriteret e masat konkrete të organizimit të formacioneve të veçanta dhe të ushtrisë në tërësi, duke kaluar nga çetat e batalionet në brigada e më pas, me rritjen cilësore të luftës dhe të organizimit ushtarak, krijimin e divizioneve dhe të korparmatave si njësi operative-strategjike; përcaktoi dhe përsosi organizimin, pajisjen dhe funksionimin e disa llojeve të shërbimeve, si atë informative, të ndërlidhjes, të xhenios, të prapavijës, artilerisë etj.; pajisjen me armatim, municion, furnizimin me ushqim e veshmbathje të formacioneve partizane; organizimin e popullit të armatosur në formacionet vullnetare territoriale si forcë rezervë në ndihmë të UNÇ-së; organizimin e drejtimin e pushtetit ushtarak të vendit (komandat e qarqeve, komandat e vendit, rojat partizane e ato vullnetare). Për secilën nga këto drejtime e detyra, Shtabi

tërësi. Mbështetur në parimet e luftës çlirimtare dhe përvojën e gjallë luftarake shumëshekullore të popullit tonë, në vartësi të etapave të zhvillimit të luftës dhe të vet ushtrisë, Shtabi përcaktoi: rregullat e kriteret e përqendrimit të forcave në kohën e vendin e duhur, përcaktimin e zgjedhjen e drejtimin të goditjes kryesore, të bashkëveprimit ndërmjet vet formacioneve partizane dhe të këtyre të fundit me formacionet vullnetare territoriale që shtriheshin në të gjithë vendin; rregullat e përballimit të operacioneve mësimëse të armikut me forca superiore. Në themel të taktikës partizane dhe të asaj me front të rregullt (kur u përdor) si dhe të përgatitjes luftarake, u vunë tiparet kryesore të taktikës partizane si shpejtësia, vrulli, shfrytëzimi i terrenit, i errësirës e motit, manovra, guximi, ruajtja e fshehtësisë së idesë dhe të forcave. Si metodë kryesore, për vetë kushtet e luftës dhe të ushtrisë

që u mbajt në Përmet më 24 maj 1944. U vendos që të kalohej në mësimje të përgjithshme strategjike për çlirimin e vendit, kalimin e ushtrisë nga ushtri vullnetare partizane në ushtri të rregullt (edhe në pamjen organizative, krahas brigadave do të krijoheshin edhe 8 divizione dhe 3 korparmata, si njësi operativo-strategjike me rreth 70.000 partizanë); vendosjen e gradave në ushtri; krijimi i Komandës së Përgjithshme si organ i njësuar ushtarak.

Komanda dhe Shtabi i Përgjithshëm drejtuan me aftësi UNÇ-në në përm-bushjen e misionit të saj përfundimtar strategjik për çlirimin e vendit. Madje, një pjesë e formacioneve partizane luftuan edhe për çlirimin e pjesës më të madhe të trojeve shqiptare jashtë kufijve të shtetit amë. Duke plotësuar me dinjitet angazhimin e vet në kuadrin e Koalicionit të Madh Antifashist Botëror, Komanda e Përgjithshme, Shtabi i Përgjithshëm dhe ushtria shqiptare ndoqën pushtuesit gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tij, që u tërhoqën me të, deri në Vishegrad (Bosnjë Jugore). Populli shqiptar, me ushtrinë e tij të udhëhequr ushtarakisht me aftësi profesionale nga Shtabi i Përgjithshëm, e radhiti më dinjitet veten në radhën e fitimtarëve duke bërë pluhur e hi edhe synimet grabitqare të shovenëve fqinjë që shpresonin e punonin që Shqipëria të radhitej me të mundurit dhe vendi të kthehej në plaçkë tregu për lakmitë shoviniste. Pikërisht kjo përbën edhe fitoren e meritën më të madhe të popullit tonë në këtë luftë dhe justifikon gjithë sakrificat duke e radhitur atë në radhët e para të popujve që kontribuan më tepër në fitoren mbi fashizmin dhe nazizmin. Ndaj edhe brezi që bëri luftën meriton nderimin e brezave më të rinj.

Ushtria pas çlirimit të vendit, në kushtet e reja politiko-shoqërore, u reduktua në sasinë numerike, u modernizua me të gjitha llojet e armëve dhe të forcave si dhe u pajis me armatim modern të kohës. Forcat e Armatosura nuk njohën asnjë ndërprerje, duke realizuar me sukses misionin e vet në mbrojtje të Atdheut. Në kushtet e transformimeve demokratike në Shqipëri, Forcat e Armatosura sërisht u transformuan në parametra të reja që burojnë nga kushtet e reja politike e shoqërore, në shërbim të lirisë dhe të paqes.



organizative të tij të përbërë nga: shtabi operativ, komisarati politik, komisarati ekonomik, sektori i brendshëm, seksioni i ndërlidhjes dhe disa specialistë. Detyrat e Shtabit të Përgjithshëm përmblidheshin në tre drejtime kryesore: organizimi i UNÇ-së, realizimi i udhëheqjes operative e strategjike të luftës dhe përpunimi i taktikës së luftës popullore.

Në fokusin e këtyre detyrave, Shtabi i Përgjithshëm, nëpërmjet urdhrave, udhëzimeve, rregulloreve, të deleguarve

i Përgjithshëm përpunoi e shpërndau urdhra e udhëzime konkrete, duke siguruar edhe zbatimin e tyre.

Përpunimi i teorisë dhe veprimeve luftarake

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i punës së Shtabit ishte edhe përpunimi i teorisë dhe i formave konkrete të veprimeve luftarake të formacioneve vartëse në veçanti dhe të ushtrisë në

më të vogël në numër, u vu metoda e asgjësimit të armikut pjesë-pjesë. Gati një vit më pas nga koha e krijimit të SHP-së, në maj 1944, situata politiko-ushtarake në vend kishte ndryshuar së tepërmi. Këtë lindi nevoja për përcaktimin e objektivave të reja e përfundimtare strategjike të luftës për çlirimin e vendit dhe kalimin e ushtrisë në një shkallë më të lartë organizimi, të aftë të përballojë detyrat e reja strategjike. Kjo u materializua me vendimet e Kongresit të Parë ANÇ,

Qendra e Personel Rekrutimit

Akademia e Forcave të Armatosura: 50 të drejta studimi për vitin akademik 2021-2022

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2021-2022, për 50 (pesëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimi universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatikë dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera). Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (1 gusht 2022). Përfundim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (1 gusht 2022); të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të plotësojë kushtin e sigurisë; të zotërojë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi bechelori) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë); të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënofficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet: të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të




mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

Procedurat e aplikimit

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë Qendrës së Personel Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënofficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandim për pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumenta-



cionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit: kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksin A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve;

fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar

Datat e testimit:

Datat e testimit për aplikantët janë përcaktuar si vijon: testi i gjuhës së huaj (anglisht) është më datë 10.08.2021, testi fizik është më datë 11.08.2021, testi intelektual është më datë 12.08.2021 dhe testi psikologjik është më datë 12.08.2021.

Shenim: Aplikanti deklaron dhe firmos se të dhënat e paraqitura në formularët përkatës janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



Jens Stoltenberg vizitë në Kosovë

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg udhëtoi më 01 korrik 2021, drejt Forcës së Kosovës të udhëhequr nga NATO, (KFOR), ku u takua me Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici, me personelin nga 27 kombe kontribuese me trupa (përfshirë aleatët dhe partnerët e NATO-s), si dhe me drejtorin e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s gjenerabrigade Jörg Ruter.

“Fakti që ne jemi kaq shumë kombe këtu nga vendet aleate të NATO-s, por edhe nga disa kombe partnere tregon forcën e misionit tonë. Kjo demonstroi përkushtimin e shumë kombeve për stabilitetin dhe paqen në Kosovë dhe në këtë rajon”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Misioni i KFOR-it është i rëndësishëm jo vetëm për Kosovën dhe rajonin, por edhe për NATO-n dhe për të gjithë aleatët e NATO-s”, theksoi Sekretari i Përgjithshëm. “Për shumë vite operacioni në Afganistan ishte më i madhi, por ndërsa flasim së shpejti do t'i japim fund këtij misioni. KFOR jo vetëm që do të jetë operacioni më i gjatë, por edhe më i madh ushtarak i NATO-s”, tha ai gjithashtu.

Gjatë vizitës së tij, Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg zhvilloi takime bilaterale me Presidenten e Kosovës Vjosa Osmani, Kryeministrin Albin Kurti dhe politikanin serb Goran Rakić. Ai riktheu përpjekjet e vazhdueshme të KFOR-it për të mirën e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe mbështetjen e palëkundur të NATO-s për Dialogun e lehtësuar nga BE dhe përpjekjet e tjera që synojnë normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës.

Fqinjësia e qëndrueshme jep siguri

“Është shumë mirë për mua të kthehem në Prishtinë përsëri, në Kosovë, dhe të mund të takoj përsëri KFOR-in dhe trupat nga kombet e ndryshme që marrin pjesë në misionin tonë shumë të rëndësishëm këtu”, tha në fjalën e tij për trupat e KFOR-it, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, dhe duke uruar në fillim Kanadanë për Ditën e tyre Kombëtare, ai tha se vetëm “fakti që ne jemi kaq shumë kombe këtu nga vendet aleate të NATO-s, por edhe nga disa kombe partnere, tregon fuqinë e misionit tonë. Kjo demonstroi përkushtimin e shumë kombeve për stabilitetin, paqen në Kosovë dhe në këtë rajon dhe duhet ta dini se misioni i KFOR-it është i rëndësishëm jo vetëm për Kosovën, për rajonin, por është gjithashtu i rëndësishëm për NATO-n dhe për të gjithë aleatët e NATO-s, sepse kemi parë gjatë gjithë historisë, se stabiliteti në këtë rajon ka rëndësi për të gjithë ne. Ka rëndësi për Evropën, ka rëndësi për NATO-n.

Kështu, siç themi shpesh në NATO, kur fqinjësia jonë është më e qëndrueshme ne jemi më të sigurt dhe ju po na ndihmoni ta arrijmë atë. Mesazhi im kryesor sot është të falënderoj të gjithë burrat dhe gratë që shërbejnë në KFOR. Të gjithë burrat dhe gratë që e kanë bërë të mundur këtë. Dhe gjithashtu e dini që ju nuk keni qenë vetëm duke u marrë me situatën e sigurisë, sfidat politike në këtë rajon në Kosovë, por gjithashtu keni qenë në një situatë ku keni pasur nevojë të merreni edhe me pandeminë, dhe përballeni me Covid-19 dhe kjo është gjithmonë e vështirë, por natyrisht është veçanërisht sfiduese në një operacion ushtarak, mision, si KFOR. Kështu që unë e di që ju keni qenë në gjendje të trajtoni pandeminë në një mënyrë profesionale dhe të përbani një numër të kufizuar të njerëzve të



36. Ne jemi duke investuar në aftësitë tona ushtarake në mënyrë që të përmbushim sfida të reja dhe të qëndrueshme në të gjitha fushat operationale. Ne vazhdojmë të ofrojmë një sërë aftësish të fuqishme dhe të sofistikuar në të gjitha fushat, përfshirë forcat dhe aftësitë më të rënda, më të larta, të përparuara teknologjikisht, të mbështetura më mirë në gatishmërinë e kërkuar. Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë dhe adaptojmë qëndrueshmërinë, vendosjen dhe ndërvëprimin e aftësive tona për një mjedis strategjik të kërkuar, si dhe operacione të nivelit të lartë. Planet tona kombëtare të zhvillimit të aftësive do të mbështesin zbatimin e plotë dhe në kohë të aftësive, veçanërisht ato të kërkuara nga Aleanca në përpunje me Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s. Në dritën e ritmit, gjerësisë dhe shkallës së zhvillimeve teknologjike, ndërsa zhvillojmë më tej forcat dhe aftësitë tona, ne njohim rëndësinë jetësore të kërkimit dhe zhvillimit dhe inovacionit për të shfrytëzuar mundësitë dhe për të adresuar sfidat e paraqitura nga teknologjitë në zhvillim dhe përçarës. Kjo do të ndihmojë për të siguruar, individualisht dhe kolektivisht, avantazhin tonë teknologjik tani dhe në të ardhmen. Ne vazhdojmë të punojmë për të adresuar, sipas rastit, varësitë ekzistuese nga pajisjet ushtarake të trashëguara nga Rusia përmes përpjekjeve kombëtare dhe bashkëpunimit shumëkombësh. Ne mirëpresim modernizimin e flotës AWACS të NATO-s dhe përparimin e programit të Aleancës për Mbikqyrjen dhe Kontrollin e Ardhmërisë, si dhe operacionet fillestare të Forcës së re të Aleancës për Mbikqyrjen Tokësore. Përmes projekteve të bashkëpunimit shumëkombësh të mbështetur nga NATO, Aleatët janë të përkushtuar të punojnë së bashku për të zhvilluar ose për të marrë aftësi të reja në fusha kryesore si furnizimi me karburant ajër në ajër, trajnim, goditje precize, municione, mbrojtje ajrore, mbrojtje CBRN, sisteme autonome dhe të tjera-aftësia e gjenerimit të rotorcraft.

(vijon në numrin e ardhshëm)



Shefi i Edukimit në detashmentin e 7-të të Kolegjit, nënkolonel Christopher Mackin, shprehë vlerësimin shumë të lartë për ta duke theksuar se, major Mulla dhe major Krelani, tani më kanë caktuar një standard të lartë të përsosmërisë akademike dhe të pjesëmarrjes së fuqishme interaktive gjatë temave studimore. Ai gjithashtu nënvizoi se, pjesëmarrja e Kosovës në degën evropiane të CGSC-së është historike sepse është për herë të parë si dhe dy oficerët e saj janë më të mirët në radhët e studentëve ndërkombëtar.



Kolegji i Shtabit dhe Komandës së Ushtrisë së SHBA-së

Major Krelani dhe major Mulla diplomohen në kolegjin amerikan

Ky diplomim shton kuadrin e oficerëve me kompetencë profesionale dhe akademike të fituar në institucion akademik ushtarak shumë prestigjioz të SHBA-së

Pas studimeve intensive dhe sfiduese, në Kolegjin e Shtabit dhe Komandës së Ushtrisë së SHBA-së (US Command and General Staff College- CGSC), në degën evropiane të saj në Grafenwoher të Gjermanisë, me sukses të lartë diplomuan, oficerët e FSK-së, major Vegim Krelani dhe major Jaser Mulla.

Lidhur me performancën gjatë studimeve dhe suksesin e arritur të dy oficerëve të FSK-së, shefi i Edukimit në detashmentin e 7-të të Kolegjit, nënkolonel Christopher Mackin, shprehë vlerësimin shumë të lartë për ta duke theksuar se, major Mulla dhe major Krelani, tani më kanë caktuar një standard të lartë të përsosmërisë akademike dhe të pjesëmarrjes së fuqishme interaktive gjatë temave studimore. Ai gjithashtu nënvizoi se, pjesëmarrja e Kosovës në degën evropiane të CGSC-së është historike sepse është për herë të parë si dhe dy oficerët e saj janë më të mirët në radhët e studentëve ndërkombëtar. Diplomimi i major Krelanit dhe major Mullës, shton kuadrin e oficerëve me kompetencë profesionale dhe akademike të fituar në institucion akademik ushtarak shumë prestigjioz të SHBA-së. Këto kuadro dhe njohu-



ritë e tyre janë aset shumë i çmuar në kohën kur jemi në proceset shumë të rëndësishme të tranzicionit të FSK-së dhe shumë të nevojshme në perspektivën e saj zhvillimore në përgjithësi.

Kolegji i Shtabit dhe Komandës së Ushtrisë së SHBA-së është kolegji ushtarak post-diplomik një-vjeçar dhe shkollon oficerë ushtarakë amerikanë



dhe të huaj. Ky shkollim në aspektin e edukimit profesional ushtarak konsiderohet si i domosdoshëm për oficerët e nivelit të mesëm për zhvillim të mëtutjeshëm në karrierë. Fokusi i shkollimit është në udhëheqje, histori ushtarak, planifikim ushtarak, procese të vendim-marrjes ndërsa rëndësi e veçantë i jepet mendimit kritik.

AKADEMIA E MBROJTJES E FSK-SË

Diplomohen 15 kadetët e gjeneratës 21

Në ambientet e kazermës "Adem Jashari", u mbajt ceremonia ushtarake e diplomimit të kadetëve të Akademisë së Mbrojtjes të FSK-së, respektivisht Qendrës për Studime Universitare të gjeneratës 2021. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë, ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj, zv. ministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, komandanti i FSK-së gjenerallejtnant Rrahman Rama, stafi i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe SHP të FSK-së, atashë ushtarakë të vendeve partnere, oficerë të NALT-it, si dhe familjarë të kadetëve të diplomuar. Pas ceremonisë së nderimit të flamurit, me fjalë përshëndetëse, të pranishmëve iu drejtua, komandanti i Komandës së Doktrinë dhe Stërvitjes (KDS), komandë brenda së cilës vepron edhe Akademia e Mbrojtjes dhe QSU, gjeneral brigade Irfete Spahiu. Gjeneral



Spahiu në adresimin e saj, u rikujtoi kadetëve rrugëtimin e përbashkët me të gjitha strukturat e komandës që udhëheq, për të realizuar arritjen e standardeve më të larta profesionale dhe akademike me programin tejet sfidues për përgatitje psikike, fizike, profesionale dhe intelektuale. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së gjenerallejtnant Rrahman Rama, në mesazhin e tij drejtuar kadetëve të diplomuar, i inkurajoi të qëndrojnë konsistentë në realizimin e synimeve me frymën dhe shpirtin luftarak gjithmonë duke ruajtur prestigjin e FSK-së dhe vlerat themelore të ushtarakut, si Detyrën, Nderin dhe Atdehun. Ai gjithashtu, shprehu falënderimin për partnerët tanë të cilët me mbështetjen e madhe mundësuan zhvillimin dhe avancimin e QSU-së. Në emër të ministrit të Mbrojtjes Armend Mehaj, në fjalën e tij, zv. ministri Sylja u rikujtoi kadetëve rrugëtimin me përplot sprova e sfida gjatë studimeve. Ai gjithashtu, shprehu besimin e plotë në suksesin dhe fitoren e garantuar të tyre në përmbytjen e misionit gjatë shërbimit si lider ushtarak sepse gjithmonë do të udhëhiqen nga vlerat e shenjta të ushtarakut, Detyrës, Nderit dhe Atdehut. Të gjithë shprehën mirënjohjen dhe falënderimin për mbështetjen e madhe nga ana e familjarëve të kadetëve, duke shprehur besimin se si oficerë nga sot do të arrijnë shkathësitë e duhura për pjesëmarrje dinjitoze edhe në operacionet jashtë vendit, që me gatishmërinë profesionale dhe morale t'i shërbejnë njerëzimit dhe paqes kudo ku ka nevojë. Ceremonia përkatesë vazhdoi me ndarjen e diplomave për 15 kadetët e diplomuar nga ana e ministrit Mehaj, zv. ministrit Sylja, gjeneral Ramës dhe gjeneral Spahiut. Në mesin e të diplomuarve ishin edhe dy kadetë nga Republika e Shqipërisë.

BUNDESTAGU GJERMAN

Zgjatet mandati i ushtarëve gjermanë në Kosovë

Ushtarët gjermanë mund të qëndrojnë për së paku edhe një vit tjetër në Kosovë. Parlamenti gjerman vendosi natën duke u gdhirë e premjtja, më 25 qershor 2021, ta vazhdojë mandatin e Bundeswehr-it në kuadër të Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë së Kosovës (KFOR) me kërkesë të Qeverisë Federale, në një votim me emër, me 468 vota pro, 127 kundër dhe katër abstenime. Votimi u bazua në një rekomandim të Komisionit të Punëve të Jashtme dhe të Komisionit të Buxhetit. Ky i fundit kontrollon realizueshmërinë financiare të tij.


Detyra kryesore e forcave të Bundeswehr-it në kuadër të KFOR-it është të mbështesë zhvillimin e Kosovës në një vend të qëndrueshëm, demokratik, multietnik dhe paqësor. Misioni është në thelb i pakufizuar në kohë, por më 17 qershor 2000, Qeveria Federale siguroi në një takim të Komitetit të Punëve të Jashtme se do t'ia referonte



çështjen Bundestagut Gjerman çdo dymbëdhjetë muaj për sa kohë zgjat mandati. Qeveria Federale do t'i japë përsëri Bundestagut Gjerman një mandat konstituiv për të zgjatur vendosjen nëse një nga grupet parlamentare dëshiron.

Zgjatja e fundit e mandatit të Bundeswehr-it në KFOR u bë më 17 qershor 2020. Një vit më përpara, më 28 qershor 2019, ishte ulur kufiri i sipërm i

numrit të ushtarëve që mund të vendosehin në Kosovë nga 800 në 400. Ky kufi i sipërm do të vlejë edhe për mandatin e ardhshëm. Meqenëse situata e sigurisë është kryesisht e qetë dhe e qëndrueshme, numri i vërtetë i ushtarëve të vendosur është zvogëluar ndjeshëm në vitet e fundit. Por, nëse është nevojë, Bundeswehr-i mund të reagojë shpejt dhe në mënyrë fleksibile ndaj një përqendrimi të papritur të situatës.



Gjenerali Gurchinovski shprehu mirënjohjen e tij për Gjeneral Guler, për mbështetjen dhe ndihmën pa rezervë të ofruar nga Republika e Turqisë, jo vetëm në procesin e integritetit, por edhe në anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Gjeneral Gurchinovski gjithashtu vuri në dukje pjesëmarrjen e përbashkët në operacionet paqeruajtëse, veçanërisht në Afganistan, ku një numër i madh i misionëve kanë qenë nën patronimin e kontingjentit turk.



SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM VIZITË ZYRTARE NË TURQI

Gurchinovski-Guler: Bashkëpunimi ushtarak me Turqinë do të vazhdojë

Bashkëpunimi ushtarak konsiston në ofrimin e pajisjeve ushtarake, trajnimeve, stërvitjeve të përbashkëta, etj.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë maqedonase, Gjenerallejtnant Vasko Gurchinovski, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Turqi, ku është prituri, ka zhvilluar bisedime dhe ka firmosur një marrëveshje me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneral Yaşar Guler.

Pas nderimeve ushtarake, gjeneralët Gurchinovski dhe Guler kanë diskutuar lidhur me bashkëpunimin dypalësh ushtarak, por edhe intensifikimin e mundësive për zgjerimin e mëtejshëm ushtarak, përmes formave të reja të bashkëpunimit të përbashkët si: trajnimet dhe stërvitjet e përbashkëta, pjesëmarrja në misione dhe përdorimin e kapaciteteve të dy ushtrive.

Gjenerali Gurchinovski shprehu mirënjohjen e tij për Gjeneral Guler, për mbështetjen dhe ndihmën pa rezervë të ofruar nga Republika e Turqisë, jo vetëm në procesin e integritetit, por edhe në anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Gjeneral Gurchinovski gjithashtu vuri në dukje pjesëmarrjen e përbashkët në



operacionet paqeruajtëse, veçanërisht në Afganistan, ku një numër i madh i misionëve kanë qenë nën patronimin

e kontingjentit turk.

Delegacioni i ushtrisë maqedonase i drejtuar nga gjeneral Gurchinovski

ka vizituar Komandën e Forcave Speciale turke, si dhe një pjesë të industrisë ushtarake turke.

Republika e Turqisë, si partneri strategjik i Maqedonisë së Veriut, është një faktor dhe kontribuues i rëndësishëm në modernizimin e ushtrisë maqedonase dhe pajisjen e saj me mjete të reja, moderne, të përputhshme me standardet e vendeve anëtare të NATO-s, përfshirë dhurimin më të fundit të disa automjeteve ushtarake. Si pjesë e bashkëpunimit të ndërsjellë ushtarak, Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore ka marrë pjesë në 13 misione në Afganistan, në operacionin e NATO-s, "Mbështetjes së Vendosur", konkretisht në Shtabin e Përgjithshëm të Komandës së Trajnimit, Këshillimit dhe Ndihmës në Kabul.

MINISTRJA SHEKERINSKA NË ZONËN E PRESPËS

Zhvillohet stërvitja e shpëtimit në mal në rast të aksidenteve malore

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska gjatë qëndrimit në Prespë vizitoi pjesëtarët e Armatës, të cilët me dy aktivitete në terren konfirmuan rolin e tyre të rëndësishëm-të jenë të gatshëm në çdo kohë për të ndihmuar qytetarët.

Në rajonin e Prespës, pjesëtarët e Forcës Ajrore, së bashku me Shërbimin e Shpëtimit Malor të Kryqit të Kuq, kanë realizuar një stërvitje lidhur me operacionet e shpëtimit në mal në rast të aksidenteve malore. Stërvitja përfshinte praktikimin e operacioneve të shpëtimit me helikopter, në mënyrë që të rritet efikasiteti i veprimit të koordinuar në rast aksidentesh komplekse në mal. Në prani të ministres Shekerinska, u realizua një operacion shpëtimit në një aksident të simuluar në terren të paarrtshëm në një shkëmb dhe në liqen. "Si me stërvitjen e fundit në Ohër, ashtu edhe me stërvitjen e



sotme në Prespë, ne jemi duke zhvilluar kapacitete të përbashkëta dhe koordinim me Kryqin e Kuq, sepse vetëm në atë mënyrë mund të jemi efektivë kur lind nevoja për një operacion urgjent shpëtimit," -tha ministrja dhe shtoi se "stërvitjet përmirësojnë sistemin e reagimit gjatë aksidenteve". Në të njëjtën kohë, me kërkesë të vetëqeverisjes lokale, njësisë inxhinierike e Armatës me mekanizimin

e vet iu bashkua fushatës së komunës së Resnjës "Prespa Ime, Prespa e pastër" për rregullimin e bregut të Liqenit të Prespës. Ministrja Shekerinska gjatë vizitës së saj në njësinë inxhinierike të angazhuar në breg,


tha se ky aktivitet është një shembull i vërtetë se Armata vazhdon të jetë një mbështetje e fortë për qytetarët dhe pushtetet lokale. "Armata edhe në kulmin e pandemisë, por edhe sot vazhdon të vërë të gjitha aftësitë e saj në shërbim të qytetarëve. "Qytetarët e shohin atë dhe kjo është arsyeja pse ata kanë besimin më të madh në pjesëtarët e Armatës," -tha ministrja në Prespë.

Ministrja Shekerinska: NATO është suksesi ynë

"Të dy marrëveshjet që mbajnë emrat e dy liqeneve, Ohri dhe Prespa, kanë të njëjtin mision-të krijojnë një demokraci multietnike funksionale, të integruar në Bashkimin Europian dhe në NATO". Këtë theksoi Ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska e cila foli në konferencën "Ruga deri në Prespë" në kuadër të Dialogut të Forumit të Prespës në Ohër. Shekerinska tha se pikërisht për shkak të Marrëveshjes së Ohrit dhe Prespës, ndryshimi midis imazhit të Maqedonisë së Veriut në vitin 2001 dhe sot është i madh. 20 vjet më parë ne i bëmë thirrje NATO-s të vinte në vend dhe të ruante stabilitetin dhe unitetin, dhe sot Maqedonia e Veriut është një vend anëtar i të njëjtës Aleancë. Siç theksoi ministrja, ndryshimi midis dy marrëveshjeve është se Marrëveshja e Ohrit kishte një ndikim të fortë ndërkombëtar, ndërsa Marrëveshja e Prespës është një produkt i brendshëm, rajonal.

"Suksesi i madh i rajonit është fakti që Marrëveshja e Prespës është një produkt i brendshëm, d.m.th. rajonal dhe që flet shumë për progresin e bërë nga vendet në rajon dhe rajoni në tërësi," -tha ministrja. Ne patëm besim dhe me të vërtetë sollëm rezultate, me udhëheqje, entuziazëm dhe njohuri, tha Shekerinska dhe përfundoi: "NATO është suksesi ynë. Shpresoj se Europa do t'u dërgojë gjithashtu një mesazh të fuqishëm vendeve të tjera të rajonit se vendimet e vështira dhe të guximshme vlerësohen..."





“Ne i trajtojmë llojet e forcave të armatosura me vëmendje dhe përgjegjësi të barabartë. Unë jam i vetëdijshëm për problemin, por në çdo formacion ushtarak takohem me personelin për të dëgjuar përshtypjet nga dora e parë. Këta njerëz me punën e tyre meritojnë të dëgjohen”, tha Admirali Eftimov. Programi i vizitës së tij përfshinte një takim me personelin e batalionit të mekanizuar”.



SHEFI I MBROJTJES BULLGARE ADMIRALI EMIL EFTIMOV

Ushtria Bullgare vazhdon punën për zbatimin e detyrave

Batalioni i Dhjetë i Mekanizuar është i një rëndësie të duhur për sistemin e sigurisë kombëtare, Forcat e Armatosura dhe Forcat Tokësore

Batalioni i Dhjetë i Mekanizuar është i një rëndësie të duhur për sistemin e sigurisë kombëtare, Forcat tona të Armatosura dhe Forcat Tokësore”, tha Shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov më, 5 korrik, gjatë një vizite në formacionin ushtarak në Vratsa. Ai u njoh aty për aty me organizimin dhe veprimtarinë, shqyrtoi mjediset e trajnimit dhe projektet në vazhdim të infrastrukturës për të përmirësuar kushtet për funksionimin e formacionit ushtarak. “Ministria e Mbrojtjes ka ndarë mjaft fonde për të realizuar këto projekte infrastrukturore. Ajo që shoh këtu më jep shpresë”, ishte kategorik Admirali Eftimov. Ai shprehu besim se përmirësimet në infrastrukturën e batalionit do të kontribuojnë në rritjen e motivimit të ushtarakëve, por gjithashtu demonstrojnë qëndrimin e merituar të shtetit dhe ushtrisë bullgare për punën e tyre domethënëse.

“Ne i trajtojmë llojet e forcave të armatosura me vëmendje dhe përgjegjësi të barabartë. Unë jam i vetëdijshëm për problemin, por në çdo formacion ushtarak takohem me personelin për të dëgjuar përshtypjet nga dora e parë. Këta njerëz me punën e tyre meritojnë të dëgjohen”, tha Admirali Eftimov. Programi i vizitës së tij përfshinte një takim me personelin e batalionit të mekanizuar. Në të morën pjesë gjithashtu Komandanti i Forcave Tokësore, Gjeneral Majori Mihail Popov, Drejtori i Shtabit të Mbrojtjes, Gjeneral Majori Stayko Prokopiev, si dhe Drejtorët e Drejtorive të Logjistikës dhe Planifikimit Strategjik në Shtabin e Mbrojtjes, Gjeneral Brigade Mitko Grigorov dhe gjeneral brigade Krastev.

“Për të kryer detyrat, batalioni i mekanizuar ka nevojë për mbështetje të burimeve. Rritja e stafit është e pranishme në planet tona për formacionin ushtarak në mënyrë që ai të mund të kryejë një gamë më të gjerë të detyrave. Ne po analizojmë gjithashtu se si mund të ruajmë dhe rrisim fuqinë e zjarrit dhe manovrueshmërinë e Batalionit të Dhjetë të Mekanizuar”, tha Shefi i Mbrojtjes pas bisedës me personelin. Ai theksoi se në garnizonin e Vratsa ka interes për shërbimin ushtarak, pasi në konkursin e fundit për një vend aplikuan katër ose pesë persona, që është mbi mesataren e vendit.

Në përgjigje të pyetjes së një gazetari, Admirali Eftimov tha se për të, si shef i mbrojtjes, përparësia ishte fillimi i aktiviteteve të planifikuara fluturuese të avionëve luftarakë. “Ne kemi rifilluar aktivitetet e planifikuara të fluturimit të transportit, sulmit dhe aviacionit me helikopter. Unë jam duke pritur që njësi e specializuar për hetimin e aksidentëve ajrore në Shërbimin e Policisë Ushtarake të nxjerrë raportin e saj. Nëse do të lidhet me të dhënat përfundimtare nga “kutia e zezë” e MiG-29, apo do të dalë më



herët me rekomandimet e nevojshme në mënyrë që të mund të rinisim aktivitetin e fluturimit, unë jam duke pritur për këtë përfundim. Shpresoj shumë që deri në fund të korrikut të rifillojmë trajnimin e fluturimit të aviacionit,” tha Shefi i Mbrojtjes. Ai ishte i prerë

se pavarësisht nga incidenti tragjik, Ushtria Bullgare vazhdon punën e saj të synuar, të planifikuar dhe zbatimin e detyrave të saj. Admirali Emil Eftimov përsëriti rëndësinë e faktit se “kutia e zezë” dhe rrënojat e avionit u zbuluan nga Flota Detare me fondet e veta. “Ne

kemi provuar që me pajisjet që kemi, ne mund të kryejmë detyrat tona. “Nuk duhet të ketë skepticizëm në lidhje me gatishmërinë e ushtrisë sonë për të kryer detyrat e saj, përgjegjësinë e saj dhe angazhimin e saj ndaj sigurisë kombëtare,” përfundoi shefi i mbrojtjes.

Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Përmirësimin e Menaxhimit të Krizave të NATO-s

Në Sofje, Rumania pranohet si anëtare e CMDRCOE

Qendra për Kërkimin, Zhvillimin dhe Përmirësimin e Menaxhimit të Krizave të NATO-s dhe Aftësive të Reagimit ndaj Fatkeqësive (CMDRCOE) në Sofje, si dhe të gjitha strukturat e tjera të ngjashme në Evropë dhe botë, kontribuojnë në bashkëpunimin midis vendeve anëtare. Kjo u deklarua nga Ministri i Mbrojtjes Georgi Panajotov, më 2 korrik, në ceremoninë solemne me rastin e pranimit të Republikës së Rumanisë në CMDRCOE-organizata ndërkombëtare ushtarake, pjesë e strukturës së NATO-s e vendosur në Bullgari. “Ne jetojmë në një kohë kur ne, vendet anëtare, duhet të tregojmë unitet dhe solidaritet me shumë se

kurër. Sepse është e rëndësishme sot të tregojmë se jemi të gatshëm për të mbrojtur lirinë dhe demokracinë, pavarësinë dhe prosperitetin, për të mbrojtur vlerat tona”, tha Ministri Panayotov. Ai iu drejtua Ambasadorit të Rumanisë znj. Brundusa-Ioana Predescu dhe theksoi: “Unë jam shumë krenarë që ne po ngremë flamurin e Rumanisë sot.” Ai dëshiroi që më shumë vende të bëhen pjesë e strukturës së NATO-s në Sofje.

“Pranimi i një vendi tjetër sponsor në Qendrën për Kërkime, Zhvillim dhe Përmirësimin e Menaxhimit të Krizave të NATO-s dhe Aftësive të Reagimit ndaj Katastrofave është një sukses i jashtëzakonshëm. Kjo do të rrisë aftësinë e qendrës për t’iu përgjigjur një game më

të gjerë sfidash dhe rreziqesh aktuale. Unë e përgëzoj ekipin e qendrës për këtë zgjerim të vlefshëm”, deklaroi Zëvendës Shefi i Mbrojtjes Gjeneral Lejtnant Dimitar Iliev në fjalën e tij përshëndetëse në ceremoni. Drejtori i CMDRCOE kolonel Orlin Nikollov shprehu besimin se pranimi i Rumanisë do të kontribuojë në prestigjin ndërkombëtar të qendrës. Pranimi i Rumanisë në Memorandumin e Mirëkuptimit u nënshkrua në 29 qershor në Norfolk, SHBA, midis Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Bullgarisë, Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës Greke, Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Polonisë, Ministria e Punëve të Jashtme të Rumanisë dhe Komanda e Përbashkët e Transformimit.

Betohen 40 ushtarakë të rinj në Operacionet Speciale

Festa ushtarake e garnizonit të Plovdivit u festua më 4 korrik me një betim ushtarak nga ushtarakët e Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale (JCC). Një total prej 40 ushtarakësh të rekrutuar rishtazi “u betuan” gjatë ceremonisë zyrtare, e cila u zhvillua në Sheshin Qendror. “Bëhuni luftëtarë trima dhe trima. Shërbeni me përkushtim dhe profesionalizëm në një nga formacionet më të larta të Ushtrisë Bullgare. Komandantët dhe kolegët tuaj do të jenë mësues të shkëlqyeshëm se si të mbrojnë moton “Aty ku të tjerët nuk mundin” me vullnet të fortë dhe shpirt luftarak”, tha në përshëndetjen e tij Zëvendës Shefi i Mbrojtjes, Gjeneral Lejtnant Dimitar Iliev. Ai u bëri thirrje ushtarakëve që të tregojnë vullnet dhe shpirt luftarak, të zhvillojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre individuale për punën në ekip, të përballen me detyrat e tyre dhe t’i qëndrojnë besnikë betimit të dhënë - një simbol i devotshmërisë, detyrës dhe nderit. “Sot ju u betuat për besnikëri Forcave Speciale të Ushtrisë Bullgare, Ushtrisë Bullgare dhe Atdheut, por gjithashtu ju betuat besnikëri familjeve tuaja dhe komandantëve tuaj të drejtpërdrejtë. Jam i bindur se secili prej jush i ka thënë fjalët e betuara me vetëdije të plotë, besim dhe shpresë. Besoj se tani e tutje ju e kuptoni përgjegjësinë e madhe që shtrihet para jush. Ju, së bashku me kolegët tuaj nga Forcat Tokësore, Forcat Ajrore dhe Flota Detare e Republikës së Bullgarisë bëheni shtylla kurriore dhe thelbi i Ushtrisë Bullgare. Jam i bindur se nuk do të kurseni forcë, vullnet dhe aftësi për të punuar pa u lodhur për prosperitetin e Forcave Speciale të Ushtrisë Bullgare dhe Bullgarisë.

ARIANIT RACAJ

Pushka legjendare

“AK-47- Kallashnikov”

Kallashnikov AK-47njihet si armë zjarri, ndërsa numri 47 ka të bëjë me vitin e prodhimit të saj. Mihail Kallashnikov ka qenë mekanik i tankeve në armatën sovjetike gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në fund të vitit 1942, forcat sovjetike ishin të preokupuara për krijimin e një arme automatike, e cila do të mund të shtinte nga një distancë deri në 400 metra. Revolverët ushtarakë të Shpaginit të cilat në atë kohë kanë qenë të famshme, nuk i plotësonin këto kërkesa dhe për këtë shkak u desh që të zhvillohej një model i ri. Duke e parë përparsinë që kishin pasur ushtarët gjermanë në kuadër të luftimeve, Kallashnikovi pati idenë që të krijonte një armë e cila do të jepte rezultate më të mira gjatë luftimeve, konkretisht një armë që secili shtet do të kishte dëshirë ta kishte. Gjatë shërbimit të tij aktiv, ai ishte përpjekur të bënte një lloj arme të tillë, duke pasur ide të shumta për disa lloje. Kur u hap konkursi për mitralozë, Mihaill Kallashnikov u paraqit me modelin “AK-46”. Ky model u miratua dhe u dërgua në fabrikën “Kovrov”, ku u prodhuan prototipet e armëve. Në një konkurs për armën më të mire, në dhjetor të vitit 1946, pushka “AK-46” e ka humbur garën me konkurentët tjerë si: “AB-46” dhe “AB”. Arsye për këtë ka qenë kompleksiteti i armës dhe për këtë shkak, arma as nuk u testua. Falë mbështetjes nga disa anëtarë të komisionit, Kallashnikovia ka dalë që t’a rishqyrtojë vendimin e tij dhe ka kërkuar leje për vazhdimin e hulumtimeve përmes të cilave do t’a përmirësonte modelin paraprak të pushkës. Në bazë të të gjitha hulumtimeve të kryera, ai në fund ka vendosur që t’a prodhojë pushkën e parë “AK-47” gjegjësisht “Kallashnikovin” e parë, në janar të 1947. Në atë kohë, version luftarak i pushkës, i njohur nën emrin “Kallashnikov”, ka fituar në një garë dhe është vendosur që të vazhdojë me prodhim masiv. Pas dy viteve të prodhimit, Në vitin 1949, “AK-47”-ta u pranua zyrtarisht nga Forcat e armatosura sovjetike dhe nisi të përdorej nga shumica e vendeve anëtare të Paktit të Varshavës. Kjo pushkë u bë simbol i lëvizjeve të ndryshme revolucionare nga Vietnami e Afganistani e deri në Kolumbi e Mozambik, në flamurin e të cilit gjendet edhe sot. Gjatë jetës së



tij Kallashnikov vazhdimisht e ka përmirësuar dizajnin duke e bërë pushkën edhe më të sigurt, më të thjeshtë, më të lirë dhe më të lehtë për t’u prodhuar. Edhe pas shtatë dekadash të përdorimit, modeli dhe versionet e tij mbeten më të famshmet dhe shumë shpesh pushkët më të përdorura në botë për shkak të sigurisë së tyre, edhe në kushte tejet të vështira, kostos së ulët të prodhimit në krahasim me armët tjera perëndimore bashkëkohore, i disponueshmërisë në pothuajse çdo rajon gjeografik dhe lehtësisë në përdorim. “AK-47”-ta ka qenë bazë për zhvillimin e shumë llojeve të tjera të armëve individuale, armëve grupore dhe armëve të specializuara. Në vitin 2004, nga rreth 500 milionë armë zjarri në botë, 100 milionë prej tyre kanë qenë pjesë e familjes “Kallashnikov”, tre të katërtat nga të cilat janë pushkë “AK-47”.

Pjesë përbërëse dhe karakteristika të “AK-47”

Pjesë përbërëse të “AK-47” janë: thika, mekanizmi kthyes, bartësi i mbyllësit me klip, hapësira e gazit me rregullatorë të gazërave, cilindri i gazit

me mbështjellës druri, mbyllës, tubë, mbrojtësi i gojës së tubës, shënjestrat, korniza, kapaku i sandëkut, sandëku me dorezë, mekanizmi i këmbëzës, kundaku, trombloni, pajisjet për pastrim. Pushka “AK- 47” veçohet

me një kosto relativisht të ulët të prodhimit, ajo është e lehtë për bartje dhe për përdorim. Kjo pushkë siguron mbrojtje dhe qëndrueshmëri. Pushka “AK-47” duhet të ketë vetëm plumba në kornizë dhe të bartet me nivel të



Gjatësia e pushkës është 870mm, me thikë prej 1070mm. Përmban kornizë me 30 plumba të llojit 7,62x39mm. Për shkak të përparësive të mëdha të kësaj pushke, ajo është bërë arma e preferuar për kriminelët e ndryshëm si dhe për shumë organizata terroriste. Në këtë mënyrë, kjo pushkë, ka rënë edhe në duart e terroristëve të cilët okupuan fshatin olimpiq gjatë lojrave olimpike në Mynih në vitin 1972, si dhe gjatë sulmeve të shumta nëpër tërë botën. Për shpikjen e tij, Mihaill Kallashnikov gjatë jetës së tij ka marrë mirënjohje të shumta. Ai ka ndërruar jetë në moshën 94 vjeçare si hero kombëtar në vitin 2013. Gjatë jetës së tij, Mihaill Kallashnikov është ballafaquar me kritika të ndryshme të cilat kanë shpjer drejt faktit se shpikja e tij, ka shkatuar një numër shumë të madh të vdekjesh në të gjithë botën. Kritikave të këtilla ai me shumë vetëbesim u është përgjigjur se kjo pushkë është shpikur që të shërbejë si armë për mbrojtje, e jo të shërbejë si armë për të sulmuar dikë. Ai çdo herë ka theksuar se kjo armë nuk është zhvilluar për të shërbyer si motiv dhune. Megjithatë, gjatë viteve të fundit të jetës së tij, Mihail Kallashnikov filloi



lartë të sigurisë, pa marrë parasysh se në cilin vend gjendeni edhe në xhunglat tropikale dhe me shi, apo në shkretëtira të tëra me rërë. Cilindri i madh i gazit dhe hapësira e madhe ndërmjet pjesëve lëvizëse, e parandalonjë ngecjen e lehtë të pushkës. Kjo pushkë automatike ruse me më shumë lloje në tërë botën, përbëhet nga tuba prej çeliku me një gjatësi prej 415 mm, me kalibër prej 7,62 mm. Kanali i tubës dhe mbrojtësi i cili është vënë për gojën e tubës, ndërsa gjendet në majën e tubës, përbëhet nga brazdat, ku ka katër hapa për rrotullimin e brazdave 1/240 në anën e djathtë, gjë që mundëson që shpejtësia fillestare e kokrrës të arrijë 600 m/s.

të ndryshonte mendimin e tij dhe të gjitha deklaratat e mëparshme në lidhje me shpikjen e tij, i ka vënë nën pikëpyetje, gjegjësisht të gjitha deklaratat kanë qenë nën relevancë të dyshimtë. Cili ka qenë rezultati i gjithë kësaj? Përgjigjen e kësaj pyetjeje do t’a gjejmë në letër të cilën Mihaill Kallashnikov ia ka lënë kishës ortodokse ruse, në të cilën thotë se dhimbja të cilën e ndjen thellë në shpirtin e tij është e papërskrueshme. Ai në këtë letër mes tjerash thotë se vazhdimisht ja parashtron një pyetje vetes duke e përsëritur me qindra herë, ndërsa pytja është: Në qoftë se pushka ime mori shumë jetë njerëzish në tërë botën, a jam unë përgjegjës për vdekjen e këtyre njerëzve?

Platforma e lajmeve e industrisë së mbrojtjes në Mbretërinë e Bashkuar “Drone Wars”

Turqia është në rrugën e saj për t’u bërë lider në tregun e dronëve

“Dronët e prodhuar nga Turqia kanë provuar veten në terren” dhe se “Turqia është tani në rrugën e saj për t’u bërë një lider në tregun e dronëve”

Platforma e lajmeve e industrisë së mbrojtjes me seli në Mbretërinë e Bashkuar “Drone Wars” publikoi një analizë në lidhje me suksesin e Turqisë në sektorin e mjeteve ajrore pa pilot (dronë). Në analizë, u tha se “Turqia tani është në rrugën e saj për t’u bërë një lider në tregun e dronëve”.

Në analizë thuhet se: “Dronët e prodhuar nga Turqia kanë provuar veten në terren” dhe se “Turqia është tani në rrugën e saj për t’u bërë një lider në tregun e dronëve”. Analiza gjithashtu bëri të ditur se Turqia ka thyer monopolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Izraelit në sektorin e dronëve.

Droni i armatosur “Bayraktar TB2” u tregua si shembull, ndërsa u theksua suksesi i jashtëzakonshëm i tyre në Libi, Siri dhe Karabakun Malor. Bëhet e ditur se suksesi i Turqisë gjithashtu ka tërhequr vëmendjen e Mbretërisë së Bashkuar. Ministri britanik i Mbrojtjes Ben Wallace përmendi dronët Bayraktar TB2 si shembuj në raportin e tij. “Ndërsa Turqia është në rrugën e saj për t’u bërë një superfuqi në fushën e dronëve, evropianët duhet të kenë turp të jenë në gjumë”, shkruhet në analizën e “Drone Wars”.

Turqia, në një kohë të shkurtër më pak se 10 vjet, hyri në mesin e prodhuesve kryesorë të droneve të armato-



sur si Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Izraeli dhe Kina dhe nënvizohet se “Bayraktar TB2”, i cili është droni i armatosur më i kërkuar, mund të mbledhë informacion në lidhje me

pozicionin e forcave armike, mund të drejtohet drejtpërdrejt ndaj aeroplanëve luftarakë drejt objektivit dhe bartjes. Droni në fjalë është në gjendje të organizojë vetë sulme falë 4 raketave

të drejtuara me laser.

Mjetet ajrore pa pilot të armatosura “që nuk janë të shtrenjta por janë efektive” të prodhuara nga kompania “Baykar” ndryshuan rrjedhën e konfliktit

duke goditur tanket, automjetet e blinduara, depot e municioneve dhe sistemet e mbrojtjes ajrore në 3 zona konflikti të armatosur, kur ato u përdorën në vitin 2020.

TURQIA MIDIS 10 VENDEVE

Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje e anijeve luftarake

Zëvendësministri i Industrisë dhe Teknologjisë, Fatih Kacir tha se “Turqia është ndër 10 vendet që mund të projektojnë, ndërtojnë dhe mirëmbajnë anijet e tyre luftarake.” Në kuadër të Samitit të Detarisë së Turqisë të zhvilluar në mënyrë hibrite në Kantierin e Stambollit nën udhëheqjen e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës u mbajt Sesi i Strategjisë së Atdheut të Kaltër.

Në fjalimin e rastit, Fatih Kacir tha se Turqia është në mesin e 10 vendeve që mund të projektojnë, ndërtojnë dhe mirëmbajnë anijet luftarake dhe ky është një sukses i Turqisë dhe industrisë së saj. Kacir tha, “Si një vend i rrethuar me dete në tre anë të tij, ne gjithmonë kemi qenë pretendtë për të siguruar civilizimin dhe ekzistencën tonë dhe të kemi një flotë të fortë.” Dhe shtoi: “Ne jemi një komb që kemi stërvitur shumë marinare heroikë dhe ne jemi nipërit e një paraardhësi që arriti fitore të mëdha detare.”

“Turqia ka një industri të mbrojtjes me normë të brendshme prej mbi 70 për qind dhe e cila tejkalon 10 miliardë dollarë në xhiro dhe 3 miliardë dollarë në eksporte.

“Ne kemi bërë përpjekje të mëdha në sistemet tokësore, ajrore dhe detare.



Vazhdojmë rrugën tonë me projekte të tilla si Hurkus, MILGEM, MILDAR. Dronët tanë janë në krye të agjendës botërore dhe janë në faqet e para të gazetave. Shpresojmë që kur të prodhojmë dronët tanë luftarakë, bota të mos flasë për F-35, por për dronët tanë. Aktualisht, vazhdon ndërtimi i luftanijes tonë TCG Anadolu.

Shpresojmë gjithashtu që të jemi në gjendje të zbrisim dhe të fluturojmë edhe dronët tanë me krahë fiks nga luftanija TCG Anadolu. Kur të arrijmë këtë objektiv ne do të jemi i vetmi vend në botë që mund ta bëjmë këtë”, ka deklaruar para pak ditësh Ministri i Industrisë dhe Teknologjisë Mustafa Varank.

DEKLARATA

Turqia vë në shërbim satelitin “Turksat 5A”

Presidenti Recep Tayyip Erdogan njoftoi qëllimin e Turqisë për të dërguar në hapësirë satelitin e ri turk “Turksat 6A” vitin e ardhshëm. Kjo deklaratë e kreut të shtetit turk erdhi gjatë ceremonisë së vënies në shërbim të satelilit “Turksat 5A” në kompleksin e Turksat-it, në rrethin Golbasi të Ankarasë.

“Ne kemi prodhuar satelitin tonë «Turksat 6A» dhe po planifikojmë që ta lëshojmë në hapësirë këtë satelit, i cili është në fazën e testimit, vitin e ardhshëm. Kështu, Turqia do të renditet në mesin e 10 vendeve që mund të prodhojnë satelitet komunikimi në botë”, u shpreh ai gjatë fjalës së rastit në ceremoni.

“Aktualisht po vazhdojnë testet e satelilit tonë «Turksat 5B», fazat e projektimit dhe prodhimit të së cilit kanë përfunduar me sukses. Objektivi ynë është që ta dërgojmë këtë satelit në hapësirë në tremujorin e fundit të vitit. Kapaciteti i ngarkesës së dobishme do të jetë më shumë sesa të gjithë satelitetë e derisotshëm dhe kapaciteti ynë i komunikimit të të dhënave do të jetë 15 herë më i lartë me funksionalizim e «Turksat 5B»”, vijoi Presidenti Erdogan.

Lideri turk bëri me dije gjithashtu se brenda një kohe të shkurtër do të ndajnë me opinionin publik edhe hulumtimet strategjike që do të mbështesin inovacionin e bazuar në të dhëna, do të zhvillojnë aftësinë e prodhimit të teknologjive kombëtare dhe nxisin progresin në inteligjencën artificiale. “Me vetëdijen që kërcënimet kryesore do të vijnë gjithashtu nga hapësira kibernetike, ne do të ndërtojmë një mekanizëm të fuqishëm të mbrojtjes kibernetike”, theksoi Erdogani mes të tjerash.





FORCAT TOKËSORE NË STËRVITJET NDËRKOMBËTARE

Hohenfels, Gjermani: Përfundon stërvitja "KFOR - 29"

*Në këtë stërvitje
morën pjesë
gjashte shtete:
Shqipëria, SHBA,
Kosova, Molda-
via, Maqedonia e
Veriut
dhe Italia*

